



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 845/4 prot.

Tiranë më 26.04.2024

URDHËR

Nr. 83, datë 26.04.2024

**PËR KONTROLLUESIN “DREJTORIA E PËRGJITHSHME E GJENDJES
CIVILE”**

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile” (në vijim, “DPGJC/Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), ka administruar ankesën e z. nr. 845 prot., datë 26.03.2024, nëpërmjet të cilës ankuesi pretendon se, ka paraqitur kërkesë pranë DPGJC-së, për korrigjim të rubrikës “Vendlindja” nga “ ” në “ ”, D , në aktin e martesës nr. , datë .1984, por nuk ka marrë zgjidhje, lidhur me këtë pretendim.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit, nëpërmjet shkresës nr. 845/1 prot., datë 28.03.2024, i është drejtuar DPGJC-së, me kërkesë për informacion, duke i bërë me dije se, bazuar në nenin 13 të Ligjit, parashikohet e drejta për të kërkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, si një e drejtë e rëndësishme e subjektit të të dhënave, që lejon këtë të fundit, për të kërkuar nga Kontrolluesi bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta ose të plota.

Kontrolluesi ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 3671/1 prot., datë 05.04.2024, administruar në Zyrën e Komisionerit nr. 845/2 prot, datë 08.04.2024, ku ndër të tjera bën

1

me dije se: “*Sipas të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, rubrika e vendlindjes për ankuesin rezulton e saktë “ ” dhe jo “ ”, siç ky përbërës rezulton në aktin e martesës. Përmbajtja e aktit të martesës, si një procesverbal i mbajtur nga palët saktësohet gjatë redaktimit që i bëhet aktit nga të pranishmit para nënshkrimit. Në dokumentet e arkivuar nuk bëhen ndryshime, saktësime të mëtejshme, por shërbehet besnikërisht me origjinalin. Referuar sa më lart parashtroam, për ankuesin janë dhënë shpjegimet e nevojshme për saktësimin e të dhënave në ndjekje të rrugës gjyqësore sipas një procesi civil njohje, nëpërmjet të cilit kërkohet deklarimi i pasaktësisë së të dhënës.*”.

Bazuar në germën “ë”, pika 1 e nenit 31 të Ligjit, në Kompetencat e Zyrës së Komisionerit, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, është edhe zgjidhja e ankimeve të subjektit të të dhënave për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tij, për përpunimet e të dhënave personale dhe vënien e tij në dijeni për zgjidhjen e ankesës së paraqitur.

Sa më sipër, me qëllim zgjidhjen sa më të drejtë të çështjes, Zyra e Komisionerit ka thirrur në një seancë dëgjimore DPGJC në cilësinë e kontrolluesit.

Në seancën e zhvilluar në datë 22.04.2024, përfaqësuesi i DPGJC-së, mbajti të njëjtin qëndrim si në kthim përgjigje e dërguar Zyrës së Komisionerit, duke shtuar se bazuar në nenin 58 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “*Për arkivat*”, punonjësit e rrjetit arkivor kombëtar shërbejnë dokumentet besnikërisht me origjinalin, pa komente ose interpretime. Në kuptim të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “*Për Gjendjen Civile*” i ndryshuar, aktet që ruhen në arkivat e zyrave të gjendjes civile janë aktet e lindjes, aktet e martesës dhe aktet e vdekjes.

Megjithatë, përfaqësuesi i DPGJC-së, për rastin konkret, pranoi se kemi të bëjmë me një “gabim material”, pasi sikurse janë shprehur edhe në shkresën “*Kthim përgjigje*” nr. 3671/1 prot., datë 05.04.2024, administruar në Zyrën e Komisionerit nr. 845/2 prot, datë 08.04.2024, nga verifikimet në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010, rubrika e vendlindjes për ankuesin rezulton e saktë “ ” dhe jo “ ”, siç ky përbërës rezulton në aktin e martesës.

Nga sa rezultoi nga seanca dëgjimore e zhvilluar me përfaqësuesin e DPGJC-së, dokumentacionin bashkëlidhur ankesës dhe provave të administruara gjatë procedurës administrative, kemi të bëjmë me një gabim “material”, bazuar në nenin 112 të ligjit nr. 144/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*” : “*Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ*”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, kontrolluesi ka detyrimin që të përpunojë/publikojë të dhëna personale të subjekteve të të dhënave duke respektuar parimin e ligjshmërisë së përpunimit dhe në përputhje me kriteret ligjore të përpunimit parashikuar në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, ku konkretisht në germën “ç”, pika 1, nenin 5, parashikohet se: “*Mbrojtja/përpunimi i të dhënave personale bazohet ndër të tjera, në saktësinë që të*

dhënat duhet të kenë, dhe kur është e nevojshme, duhet të përditësohen; duhet ndërmarrë çdo hap i arsyeshëm për të fshirë apo korrigjuar të dhëna të pasakta apo të paplota, në lidhje me qëllimin për të cilin janë mbledhur apo për të cilin përpunohen më tej”.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo subjekt i të dhënave në bazë të nenit 13 të Ligjit, ka të drejtë të kërkojë bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave dhe kontrolluesi në bazë të nenit 19 kryen vetë ose me kërkesë të subjektit të të dhënave bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave kur vihet në dijeni se të dhënat nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e Ligjit. Në këtë rast, çdo akt që vendoset në shërbim të shtetasve duhet të përmbajë të dhënat e sakta.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 5, 6, 13, 19, 29, 30 pika 1, germa “b” dhe 32 të Ligjit,

URDHËROJ:

1. Kontrolluesi “Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile”, të realizojë korrigjimin në rubrikën “Vendlindja” nga “ ” në “ ”, në aktin e martesës që i përket shtetasit z. .
2. Kontrolluesi “Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile”, të informojë subjektin e të dhënave personale z. , për korrigjimin e të dhënave personale.
3. Kontrolluesi “Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile”, mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në këtë urdhër, brenda 30 ditëve.
4. Afati i sipërpërmendur, fillon nga data e marrjes dijeni të këtij akti.
5. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Urdhrave të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative.

Ky Urdhër u shpall sot më datë 26.04.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi